# DËSHMI ARKIVI

**A-455849**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Nënë, vazhdo normalisht”/ Banda zhvat 1 milion euro nëpërmjet Inteligjencës Artificiale. Si funksiononte skema |
| ADRESA | `https://piranjat.al/bota/nene-vazhdo-normalisht-banda-zhvat-1-milion-euro-nepermjet-inteligjences-ar-i104882` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 16:24:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 16:09:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9c8e358cc3f509143a32ff18faf502483dba0fdfd39a627cb6f8bf05fb040859` |
| TEKSTI | `74ea9d5ec8e3d84ed257af1469a18764e0c618758ef34af6afa85a1022573d87` |
| PAMJA | `29cc63181610dde84992e59519f838c5fa92e89ac54800f0ac5e425a29b5b70a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `626ed7510455cec364afa23ca28d1cfb6d5629f83b8e98e046a245f04eaf8c9d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `01dec896a9f5048ec789d11efc6a4c6ac149c2dbc9d9f31c517f24c69c93634b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/626ed7510455cec364afa23ca28d1cfb6d5629f83b8e98e046a245f04eaf8c9d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA

# “Nënë, vazhdo normalisht”/ Banda zhvat 1 milion euro nëpërmjet Inteligjencës Artificiale. Si funksiononte skema

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 18:09



Një mashtrim i mirëorganizuar duke përdorur inteligjencën artificiale, përmes të cilit anëtarët e grupit kriminal klononin zërin e viktimave të tyre, ishte ngritur nga një bandë që u shkatërrua nga Drejtoria për Luftën kundër Krimit të Organizuar.

Banda vepronte që nga fillimi i korrikut të vitit të kaluar dhe dyshohet se është përfshirë në të paktën 6 raste mashtrimesh telefonike me AI, me një shumë të grabitur që arrin në rreth 1 milion euro.

Mënyra e veprimit të organizatës bazohej në inteligjencën artificiale, me anë të së cilës ata kopjonin dhe klononin zërin e viktimave. Banda vepronte në dy grupe: “telefonuesit” dhe “mbledhësit e parave”. Të parët telefononin qytetarë të pafajshëm dhe prezantoheshin ose si punonjës të (operatori grek i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, ose si ekipe që do të instalonin fibra optike. Nëse viktima e mundshme ishte dyshuese, ata i kërkonin numrin e telefonit të një të afërmi.

Më pas telefononin atë person, duke u paraqitur si gjoja shitës të një pakete telefonie celulare, dhe regjistronin bisedën. Më pas, duke përdorur teknologjinë AI, “klononin” zërin e të afërmit dhe telefononin viktimën e parë, e cila besonte se po fliste me familjarin e saj. Në këtë mënyrë e bindnin që t’u dorëzonte para dhe sende me vlerë, si bizhuteri, të cilat më pas merreshin nga shtëpia e viktimës nga “mbledhësit” e grupit.

**Dy arrestime**

Për këtë çështje u arrestuan dy persona, një 23-vjeçar dhe një 25-vjeçar, të cilët të martën pasdite u kapën në flagrancë pasi kishin marrë nga një grua e moshuar në Nea Ionia bizhuteri dhe pajisje elektronike me vlerë 30 mijë euro. Më herët, ata kishin telefonuar djalin e saj duke klonuar zërin e tij me inteligjencë artificiale. Kështu, 77-vjeçarja besonte se po fliste me djalin e saj.

Gruaja e moshuar dëgjoi zërin e rremë të djalit të saj duke i thënë: “Mami, kështu është procedura, vazhdo normalisht”, dhe kështu u bind të vendoste në një qese plastike bizhuteritë prej ari, celularin, tabletin dhe laptopin, për t’ua dorëzuar personave që pretendonin se ishin teknikë. Tre anëtarë të bandës mbërritën në Nea Ionia me një makinë të vjedhur, me targa të falsifikuara, dhe e parkuan në bulevardin Irakliou. Dy prej tyre zbritën nga automjeti dhe u drejtuan drejt pallatit ku banonte 77-vjeçarja. Pasi morën sendet e vjedhura, vrapuan drejt makinës, por për fat të keq për ta, policët po i ndiqnin nga një distancë e afërt.

Në videon-dokument që publikon protothema.gr, shihet një polic me rroba civile duke ndjekur dy autorët në trotuar, ndërsa pas tij vijnë edhe dy kolegë të tij. Ata vrapojnë në drejtim të autorëve dhe arrijnë t’i neutralizojnë, në momentin kur bashkëpunëtori i tyre ndez motorin e makinës. Në përpjekje për t’u arratisur, ai përplasi makinën e shërbimit të policisë, duke plagosur lehtë një efektiv, si edhe një automjet të parkuar. Më pas, ai vazhdoi lëvizjen e tij të çmendur në bulevardin e Irakliut. /**PiranjatNews**/

## Artikuj te sugjeruar

BOTA 18 Shtator16:09

### Policia spanjolle nis operacionet për të larguar emigrantët nga plazhet e Ceutës

Policia spanjolle ka filluar zhvendosjen e qindra emigrantëve në Ceuta në një vend të ri me tenda në zonën portuale të t...

BOTA 18 Shtator15:16

**Dhëndri i Trump Kushner sfidon Putinin në Moskë: Keni kërcënime boshe, nuk mund ta pushtoni Donbasin**

I dërguari i posaçëm i presidentit amerikan Donald Trump, Jared Kushner, ka sfiduar pretendimin e presidentit rus Vladimir Putin se Rusia mun...

BOTA 18 Shtator15:10

**Grenlanda dhe Antarktida kanë humbur 12.5 trilionë tonë akull që nga viti 1979**

Grenlanda dhe Antarktida kanë humbur gjithsej rreth 12.5 trilionë tonë akull që nga viti 1979, duke kontribuar në rritjen e nivelit g...

BOTA 18 Shtator15:01

**Policia spanjolle nis operacionet për të larguar emigrantët nga plazhet e Ceutës**

Policia spanjolle ka filluar zhvendosjen e qindra emigrantëve në Ceuta në një vend të ri me tenda në zonën portuale të...

BOTA 18 Shtator14:53

**OBSH paralajmëron për mungesë globale të punonjësve mjekësorë deri në vitin 2030**

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) paralajmëroi sot se bota do të përballet me mungesë të stafit mjekë...

BOTA 18 Shtator14:08

**Nëna e Elon Musk habit me deklaratën, zbulon se fle në garazhin e të birit: Është luks**

Nëna 78-vjeçare e miliarderit Elon Musk, Maye Musk, ka zbuluar se nuk e ka pasur kurrë problem që të jetojë në kushte t&e...

BOTA 18 Shtator13:51

**Ngjarje e rëndë në aeroport, avioni përfshihet nga flakët menjëherë pas uljes, pilotët ishin...**

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Libi, ku një avion i cili sapo ishte ulur, u përfshi nga flakët. Avioni privat Cessna Ci...

BOTA 18 Shtator13:44

**Turqia miraton marrëveshje bashkëpunimi me Brazilin në industrinë e mbrojtjes**

Turqia ka miratuar një marrëveshje bashkëpunimi në industrinë e mbrojtjes me Brazilin, sipas një vendimi presidencial të bo...

BOTA 18 Shtator13:39

**M15 pranon për herë të parë se ka paraqitur prova të bazuara në gënjeshtra në çështjen e spiunazhit neo-nazist**

Shërbimi britanik i sigurisë MI5 ka pranuar se u ka dhënë tre gjykatave prova të bazuara në gënjeshtra dhe se oficerë ...

BOTA 18 Shtator13:32

**Zbulohet krater i ri në Hënë, 222 metra i gjerë dhe 43 metra i thellë**

Një krater i ri është zbuluar në sipërfaqen e Hënës, i krijuar nga përplasja e një asteroidi që dyshohet se ...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

**"Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la"...**

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

AKTUALITET 17 Shtator

**Këta janë tre të rinjtë nga Fieri që humbën jet...**

Një aksident tragjik ka ndodhur në orët e para të mëngjesit në lagjen Glifadha të Athinës, ku kanë humbur jetë...

AKTUALITET 17 Shtator

**Ky është vendi i aksidentit tragjik ku humbën j...**

Ky është vendi ku tre të rinj humbën jetën në aksidentin rrugor në rrugën Poseidonos në Greqi, ndër...

INVESTIGIME 17 Shtator17:59

**Tensionet te Kuvendi, shoqërohen në polici të paktën 25 protestues**

Të paktën 25 persona janë shoqëruar nga policia pas tensioneve të regjistruara gjatë protestës së zhvilluar sot pran&eum...

## video



## E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





**E premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**



**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**





**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.